



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale  
Komisioneri

Nr. 1171/2 Prot

Tiranë, më 1, 10 2013

VENDIM I NDËRMJETËM

Nr. 01, datë 01/10 2013

Mbështetur në Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr. 211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nenit 78,79 të Kodit të Procedurave Administrative, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit Ministria e Drejtësisë, si dhe në zbatim të urdhërit Nr. 196, datë 01.10.2013 “Për kryerjen e inspektimit administrativ”:

KONSTATOVA

Sipas ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në cilësinë e Autoritetit publik, ju jeni kontrollues, sipas përcaktimeve të nenit 3/3 të ligjit të sipërcituar: “Kontrollues, është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhëna personale”, pra keni përgjegjësinë për përpunimin e të dhënave personale dhe si i tillë keni detyrimin të zbatoni të gjitha kërkesat e këtij ligji.

Pranë Komisionerit të Mbrojtjes së të dhënave Personale, është paraqitur ankesa e Z. D.D, që ka të bëjë me “publikimin e të dhënave personale të denoncuesve kundër korrupsionit si dhe palëve të treta në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë”. Në ankesën e tij ankuesi pretendon se, kontrolluesi “Ministria e Drejtësisë”, ka mbledhur, përdorur dhe përhapur të dhënat personale të subjekteve denoncues dhe palëve të treta në mënyrë të paligjshme dhe në shkelje të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në cilësinë e ankuesit Z. D.D me anë të ankesës Nr. 1171 prot, datë 30.09.2013 ka kërkuar mbrojtjen e menjëhershme të këtij informacioni të publikuar nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, duke zbatuar kërkesat e Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Me fillimin e inspektimit administrativ, sot me datë 01.10.2013, konstatohet se kontrolluesi “Ministria e Drejtësisë”, në portalin zyrtar të insitucionit ka në funksionim rubrikën “Ankesa Online”. Në këtë rubrike ndodhet një forëm aplikimi në të cilën kushdo mund të realizojë një “denoncim” duke patur edhe mundësinë që të bashkëlidhi dokumenta shoqëruese. Konstatohet se rubrikat e formës së aplikimit janë:

- Titulli i denoncimit
- Emri
- Telefon

- Email
- Qarku/Qyteti
- Adresa
- Teksti i denoncimit
- Video/URL
- Ngarko dokument

Nga vëzhgimi në portalin <http://ankesa.justice.gov.al> të kontrolluesit, konstatohet se pranë formës së aplikimit paraqiten edhe denoncimet e shtetasve të ndryshëm të përmbledhura në tabela. Tabela përmban kohën e publikimit, emrin e denoncuesit, titulli i denoncimit dhe përshkrimi i tij, si dhe dokumentat/video bashkëlidhur denoncimit. Nga intervistimi me drejtorin e Teknologjisë dhe Informacionit u informua se çdo denoncim kontrollohej paraprakisht nga një specialist i kontrolluesit përpara se të publikohet në portal, pra publikimi i të dhënave të mbledhura realizohet manualisht.

Sipas Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale” , nenit 5, gërma a,b,c, i cili shprehet: *a) në përpunimin në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme; b) në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë, e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime; c) “..të dhënat duhet të jenë të mjaftueshme, të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e kalojnë këtë qëllim”, të dhënat që ju keni grumbulluar për publikimin në faqen tuaj zyrtare mendohet se e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë mbledhur. Ju keni grumbulluar të dhëna personale të denoncuesve dhe të palëve të treta duke i përhapur ato dhe duke i bërë publike, çfarë rezulton në kundërshtim me nenin e sipërcituar.*

Në këto kushte gjendemi përpara faktit të një risku të madh pasi mbledhja e të dhënave për gjithë denoncuesit si dhe për palët e treta, për më tepër duke i përhapur ato, cënon rëndë privatësinë e çdo individi.

Gjithashtu kjo mbledhje e të dhënave personale dhe bërja publike e tyre nuk mund të jetë në kundërshtim të hapur me të drejtën e subjektit të të dhënave për mbrojtjen e jetës personale dhe private (palët e treta), në këtë rast kemi shkelje të nenit 6 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Nga një vëzhgim i parë pranë kontrolluesit Ministria e Drejtësisë, rezultoi se nuk ka një akt të shkruar në lidhje me ndërtimin e kësaj faqe zyrtare dhe publikimin dhe përhapjen e të dhënave personale të denoncuesve kundër korrupsionit si dhe palëve të treta, pra çka e bën këtë përpunim të paligjshëm.

Përdorimi i të dhënave të këtyre subjekteve, mund të sjellë dëme të rënda dhe të pariparueshme në lidhje me interesat e tyre dhe privatësinë, si një nga të drejtat themelore të parashikuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 35 dhe Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Gjithashtu meqenëse jemi përpara një përpunimi të ri të të dhënave personale të kategorisë së subjekteve “denoncues kundër korrupsionit”, juve ju lind detyrimi ligjor që për një qëllim të ri të njoftoni pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Në lidhje me aksesin ose përhapjen e të dhënave personale të denoncuesve dhe palëve të treta kundër korrupsionit të cilat janë publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë, jemi gjithashtu përpara shkeljes së nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “ Për mbrojtjen e të

dhënave personale”, ku citohet se: “kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”.

Në referencë të nenit Neni 30/1/b të ligjit të sipërcituar 1. Komisioneri ka këto të drejta:  
*b) urdhëron bllokimin, fshirjen, shkatërrimin ose pezullon përpunimin e paligjshëm të të dhënave personale;*

Ndërkohë sipas Kodit të Procedurave Administrative Neni 78, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka të drejtën dhe detyrimin ligjor të dalë me vendim të ndërmjetëm.

Nisur sa më sipër, në zbatim të neneve 5/1/a,b,c, 6, 27 1/ dhe 30 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe nenit 78, 79 të Kodit të Procedurave Administrative;

### V E N D O S A

1. Bllokimin dhe pezullimin e përpunimit të mëtejshëm nga ana Juaj të të dhënave personale që përmbahen në listën e denoncuesve kundër korrupsionit deri në dhënien e vendimit përfundimtar në lidhje me çështjen nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale;
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit.

Ky vendim u dha sot, me datë 01.10.2013.

**KOMISIONERI**

**Flora CABEJ (Pogaçe)**

